



TEMPULLI

Kryesuese e Këshillit Drejtues
Prof. Dr. sc. Ema Berisha Krasniqi

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19

Web: www.tempulli.org

Email: info@tempulli.org

TEMPULLI

No. 025/25 dt. 08.05.2025

Nr. Prof. PRISHTINË - KOSOVË

Data e aprovimit: 08.05.2025

Version i rishikuar

RREGULLORE MBI PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES

Bazuar në nenin 8, 11 dhe nenin 17 të ligjit “Për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës”, si dhe nenin 16 të Statutit të Kolegjit Tempulli, Këshilli Drejtues nxori rregulloren mbi punën e këshillit drejtues:

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me këtë rregullore rregullohet puna e Këshillit Drejtues (tani e tutje Këshilli) të Kolegjit Tempulli (tani e tutje Akademia) në Prishtinë.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen lidhur me organizimin e mbledhjeve, kryesimin dhe vendimmarrjen, zbatimin e vendimeve dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e Këshillit, Rregullores financiare është pjese përbërëse e Rregullores.

Puna e Këshillit Drejtues në mbledhje si dhe mbajtja e rendit aplikohet për të gjithë personat që marrin pjesë në mbledhje.

Neni 3

Këshilli i kryen punët nga kompetenca dhe fushëveprimi i vet në mbledhje të tij. Anëtarët e Këshillit Drejtues sipas autorizimeve të tyre mund të kryejnë disa punë të caktuara lidhur me detyrat e veta të punës edhe jashtë mbledhjeve sipas nevojë së paraqitur.

Neni 4

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë me të drejtë vote, nga të cilët dy anëtarë i propozon themeluesi, nga të cilët një me qenë nga këshilli i partneritetit dhe një nga shoqëria civile, dy

anëtar i propozon Këshilli Akademik dhe një anëtar e propozon Parlamenti i studentëve. Drejtori i Kolegjit, Drejtori i Institutit dhe Sekretari/ja janë anëtarë ex-officio të Këshillit Drejtues pa të drejte vote.

Neni 5

Këshilli mbledhet sipas kërkesave dhe nevojës së paraqitur në nivel të Kolegjit. Mbledhja vjetore e Këshillit mbahet në janar të çdo viti. Parimisht, Këshilli thirret në mbledhje një deri në tri herë brenda vitit, me përjashtim të rasteve kur në mbledhjen e radhës vendoset ndryshe ose kur Kryesuesi ose ndonjë anëtar kërkojnë mbledhje të jashtëzakonshme.

Neni 6

Personat të cilët nuk janë punëtorë të Këshillit, mund të marrin pjesë në mbledhje vetëm me ftesë dhe leje të Këshillit, me kusht që të ruajnë sekretin e punës.

Neni 7

Këshillin drejtues e përfaqëson Kryetari i Këshillit Drejtues.

Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Neni 8

Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të kërkojnë nga shërbimet profesionale sqarime, informata dhe materiale lidhur me punën e Këshillit.

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë në mbledhje të parashtrojnë pyetje Kryesuesit të Këshillit si dhe punëtorëve tjerë me autorizime të posaçme.

Neni 9

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë në mbledhje të diskutojnë lidhur me pyetjet sipas rendit të ditës. Gjithashtu anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të marrin pjesë aktive në diskutim dhe të propozojnë masa nga kompetencat e Këshillit.

Neni 10

Anëtari i Këshillit është i obliguar të merr pjesë në mbledhje. Anëtari mund të mungojë vetëm nga shkaqet e arsyeshme.

Neni 11

Asnjë informatë e cila merret si rezultat i mbledhjes së Këshillit nuk guxon të keqpërdoret. Këshilli, ushtron këto funksione:

1. Miratimin e statutit të Kolegjit;
2. Miratimin e Planit Strategjik të Kolegjit;
3. Vendos për strukturën e organizative të Kolegjit, në konsultim me Këshillin Akademik;

4. Zgjedhjen e Kryesuesit dhe zëvendës Kryesuesit të Këshillit Drejtues;
5. Marrjen e vendit për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve;
6. Marrjen e vendit për dhënien e bursave për studentët e dalluar;
7. Marrjen e vendit për ndarjen e medaljes së artë “Arif Krasniqi” ;
8. Marrjen e vendit për lartësinë e pagesës për regjistrimin dhe shkollimin e studenteve;
9. Miratimin e Rregullores së punës së Këshillit Drejtues;
10. Miratimin e Rregullores së Kodit të Etikës;
11. Miratimin e Rregullores së Masave Disiplinore;
12. Vendosjen për formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës, vulës së thatë, flamurit dhe simboleve të tjera;
13. Miraton buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
14. Zgjedhjen e Drejtorit të Kolegjit;
15. Miraton themelimin e programeve studimore (specializimeve) të reja, ri-emërtimin e programeve studimore (specializimeve) ekzistuese, shkririen (bashkimin) e programeve studimore (specializimeve), shuarjen e programeve studimore (specializimeve); dhe
16. Kryejë edhe punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me Statut.

Neni 12

Mbledhja e Këshillit Drejtues

Mbledhja e Këshillit quhet e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Rendi i ditës propozohet nga Kryesuesi dhe miratohet nga Këshilli. Për marrjen e vendimeve, mirëkuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme.

Neni 13

Votimi

1. Anëtarët e Këshillit janë të detyruar të marrin pjesë në votim.
2. Votimi në mbledhjet e Këshillit është i fshehtë, me përjashtim të rasteve kur cilësohet ndryshe në legjislacionin në fuqi.
3. Për marrjen e vendimeve, mirë kuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme. Mënyra e votimit të fshehtë është e detyrueshme në rastin e votimeve nominale dhe në rastet kur kjo mënyrë votimi kërkohet nga Kryesuesi ose vetë Këshilli.
4. Vendimet e Këshillit, votohen nga të gjithë anëtarët e pranishëm pa të drejtën e delegimit të votës. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë. Në rastin e votimeve të fshehta, Kryesuesi asistohet nga dy anëtarët e Këshillit, të propozuar prej tij dhe të miratuar nga Këshilli, të cilët konstatojnë rezultatet e votimeve. Anëtarët e Këshillit, që janë të pranishëm në

mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, duhet detyrimisht të shprehin qëndrimin e tyre "pro" ose "kundër". Kryesuesi voton i fundit.

5. Anëtarët e Këshillit, përveç pjesëmarrjes me praninë e tyre fizike, mund të marrin pjesë në veprimtaritë e Këshilli edhe me mënyra të tjera (online) të miratuara paraprakisht nga Këshilli për çështje konkrete. Mbledhjet e Këshillit nuk janë publike dhe vendimet e tij janë të detyrueshme për të gjitha instancat e Kolegjit.

Neni 14

Vendimi

1. Vendimmarrja behet me shumicë të thjeshtë të votave me përjashtim të rasteve kur në ligj kërkohet një shumicë absolute ose e cilësuar. Anëtarët e Këshillit nuk mund të abstenojnë. Në rast se në një proces të hapur votimi ka barazim të votave, rezultati i votimit përcaktohet nga vota e Kryesuesit.
2. Vendimi për miratimin e Statutit të Kolegjit merret me shumicë të cilësuar në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
3. Vendimet e Këshillit janë të vlefshme kur firmosen nga Kryesuesi ose Zëvendës Kryesuesi.
4. Vendimet e Miratuara nga Këshilli janë të detyrueshme për zbatim nga çdo instance tjetër e institucionit brenda afateve dhe procedurave të përcaktuara në vendim.
5. Çdo shmangie, vonese, neglizhence apo keqadministrim i vendimeve analizohet rast pas rasti në mbledhjet e Këshillit duke vendosur edhe për marrjen e masave konkrete për rivënien në vend të rregullit dhe disiplinës.

Neni 15

Publikimi i vendimeve

1. Të gjitha vendimet e Këshillit janë publike.
2. Mbledhjet e mbledhjeve të Këshillit nuk janë publike, por në to mund të ftohen persona të jashtëm për mendime: Koordinatorët e programeve dhe administratorët mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit. Kryesuesi i Akademisë Tempulli ka mandatin nga Këshilli për të nënshkruar dokumente zyrtare në emër të Këshillit.

Neni 16

Largimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Anëtarët e Këshillit kanë mandat katër vjeçar me të drejtë rizgjedhje.
2. Anëtarët e Këshillit mund të largohen nga ky organ me vullnetin e tyre (në rast dorëheqje), kur mungon pa arsye në tri seanca mbledhjesh ose me mbarimin e mandatit.
3. Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit realizohet me rekomandim të themeluesve, anëtarëve të tjerë të Këshillit dhe atë për arsye bindëse, dhe të bazuara si:

- 3.1 Dënim për një vepër të rëndë penale që ndëshkohet me burgim prej më shumë se gjashtë muajsh;
- 3.2 Paaftësi në kryerjen e funksioneve të postit të tij për shkak të paaftësisë fizike apo mendore, të dokumentuar me një raport nga një konsilium i mjekëve të pavarur, i caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose sjellje, e cila paraqet dështim, refuzim, shpërfillje, paaftësi të vazhdueshme për të përmbushur detyrat e postit që ushtron, ose për të vepruar në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë statut apo me ligj.

Neni 17

Shkarkimi i Kryesuesit të Këshillit Drejtues

1. Shkarkimi i Kryetarit dhe zëvendës kryetarit nga Këshilli bëhet:
- 1.1 Me kryerjen e një vepre penale që ndëshkohet me burgim prej më shumë se gjashtë muajsh, e cila duhet të konfirmohet me aktgjykim të plotfuqishëm;
- 1.2 Për paaftësi mendore a fizike;
- 1.3 Për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe të Kolegjit;
- 1.4 Në rast të dështimit të përmbushjes së obligimeve që derivojnë nga Statuti i Kolegjit.

Përgatitja e mbledhjes së këshillit drejtues

Neni 18

Propozimin e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit e cakton Kryesuesi i Këshillit.

Neni 19

Materialin për mbledhjen e Këshillit drejtues e përgatitë Kryesuesi nëpërmes të shërbimeve profesionale të Kolegjit. Materiali për mbledhje dërgohet së bashku me thirrjet.

Neni 20

Në mbledhjen e Këshillit përveç anëtarëve mund të thirrën sipas nevojës edhe persona tjerë.

Mbledhje e këshillit drejtues

Neni 21

KD udhëhiqet nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues, ose në mungesë të Kryesuesit nga Zëvendës Kryesuesi. Në rast kur Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi mungojnë në mbledhje, atë e udhëheqë anëtari më i vjetër e Këshillit Drejtues.

Mbajtja e procesverbalit

Neni 22

1. Para fillimit të rendit të ditës të mbledhjes, Këshilli aprovon rendin si dhe procesverbalin nga mbledhje e kaluar. Ne çdo mbledhje të Këshillit mbahet procesverbali përkatës.
2. Përmbajtja e procesverbalit përfshin:
 - 2.1. orën, datën, vendin e mbledhjes;
 - 2.2. liste prezencën e pjesëmarrësve në mbledhje;
 - 2.3. rendin e ditës;
 - 2.4. propozimet, çështjet e diskutuara nga anëtarët e Këshillit;
 - 2.5. formën dhe rezultatin e votimeve;
 - 2.6. çdo informacion apo dokument, objekt diskutimi dhe vendim marrjeje.
3. Procesverbali i paraqitet për shqyrtim e miratim anëtareve të Këshillit në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.
4. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi i mbledhjes.
5. Në rastet kur çështjet e propozuara zgjasin më shumë se një mbledhje, procesverbali miratohet nga anëtarët e Këshillit në përfundim të kësaj çështjeje;
6. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë verifikimin e përmbajtjes së procesverbalit dhe të kërkojë plotësimin dhe korrigjimin e tij.

Neni 23

Diskutimet në mbledhjen e Këshillit zhvillohen vetëm për çështjet të aprovuara nga rendi i ditës. Në raste të veçanta rendi i ditës mund të plotësohet.

Neni 24

Këshilli merr masa dhe vendosë për të gjitha çështjet që janë në interes të përgjithshëm për mirëvajtjen, kryerjen në mënyrë sa më efikase të punëve brenda kompetencave të tij në Kolegjin Tempulli.

Neni 25

Këshilli mund të formoj komisione apo grupe punuese profesionale për lëmi të caktuara. Këto komisione, grupe punuese do të paraqesin raporte për punën e tyre Këshillit.

Neni 26

Konfidencialiteti

Ecuria e mbledhjes, çdo diskutim apo debat i bërë nga anëtarët e Këshillit dhe kushdo tjetër që merr pjesë në mbledhje gjatë zhvillimit të saj, konsiderohen konfidenciale.

Neni 27

Ruajtja e arkivës

Procesverbalet, vendimet dhe çdo dokumentacion i shqyrtuar ne mbledhjet e Këshillit të Administrimit ruhen dhe arkivohen ne përputhje me përcaktimet e ligjit për arkivat.

Neni 28

Vendimet dhe masat e aprovuara ne Këshillin drejtues janë të obliguara për të gjithë punëtorët e Kolegjit Tempulli.

VI. Dispozitat përfundimtare

Neni 29

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja nr. 001/20 e datës 14.10.2020

Neni 30

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Kryetarja e Këshillit Drejtues

Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi



